



Datë: 16.05.2025
Numër protokoli: 3473/2025

A.nr.477/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.477/2025, të datës 17.03.2025, të parashtruar nga ankuesja F.H , kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 16.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.477/2025, e datës 17.03.2025, e parashtruar nga ankuesja F.H.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, F.H (tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 17.03.2025, përmes emailit ankesa.kpmschck@rkspgov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos përditësimit të ditëve të pushimit vjetor në raport me vendimin për njohjen e përvojës së punës nr.24/2025 të datës 30.01.2025, të Udhëheqësit të Njesisë së Personelit të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 19.03.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 16.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 1729/2025 të datës 17.03.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 24/2025 të datës 30.01.2025 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore; Vendimin me Nr. 649 të datës 16.05.2024 të u.d Menaxherit të Personelit; Emailin e datës 10.03.2025 nga E.P për ankuesen; Emailin e datës 10.03.2025, 27.02.2025 nga ankuesja për E.P dhe E.T; Emailin e datës 14.03.2025 nga M.P për ankuesen; Lista e pushimeve vjetor për vitin 2024 dhe 2025; Kopjen e ID-së së

ankueses; Emailin e ankuese të datës 17.03.2025 për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Plotësimin e ankesës datë 21.03.2025; Emailin e datës 20.03.2025 nga A.K për ankuese dhe N.K; Emailin e datës 14.03.2025 nga ankuesja për A.K dhe N.K; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.03.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 16.04.2025; Akt Emërimin 01nr.112-1161 i datës 28.06.2019; Kërkesën për pushim vjetor ë datës 14.03.2025 dhe 01.08.2024; Raportin e ndërprerjes së përkohshme të punës për periudhën 27.03.2025 deri 04.04.2025; Marrëveshjen për shërbime të veçanta e viti 2017; Shkresë nga IOM e datës 10.10.2019; Vendimin e datës 28.04.2025 për vazhdimin e afatit për vendosje të ankesës së ankueses; Vendimi A.nr.1621/2024 i KPMSHCK-së.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa është e pabazuar, **sepse**:

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimin 01 nr.112-1161 të datës 26.08.2019, mbanë pozitën e punës Zyrtare për Shëndetësi në Drejtorinë e Shëndetësisë, pranë Komunës së Prishtinës.

Tutje sipas shkresave të lëndës rrjedhë së Menaxheri i Personelit të Komunës së Prishtinës, më Vendimin Nr. 649 të datës 16.05.2024, ankueses i ka njohur përvojën e punës prej 11 vjet e 1 muaj, vendim të cilin ankuesja e kishte kundërshtuar më ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa, ky i fundit më Vendimin A.nr.1621/2024 të datë 31.12.2024, ka aprovuar ankesën e ankueses dhe ka obliguar Njësinë e Personelit të Komunës së Prishtinës, të shqyrtoj kërkesën e ankeses lidhur me njohjen e përvojës së punës.

Me qëllim të zbatimit të vendimit të A.nr.1621/2024 të datë 31.12.2024 tw Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Menaxheri i Personelit të Komunës së Prishtinës, më Vendimin Nr.24/2025, të datës 30.01.2025, ka njohur ankueses njëzet e një (21) vite e tre (3) muaj përvojë pune.

Ankuesja më datë 27.02.2025, përmes emailit i është drejtuar më kërkesë Udhëheqësit të Njësisë së Personelit duke kërkuar që të informohet lidhur me ditët që i takojnë të pushimit vjetor pas vendimit të datës 30.01.2025, dhe njëkohësisht ka kërkuar përditësimin e pushimit vjetor, ndërsa, Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore me datë 10.03.2025 ka njoftuar ankuesen në raport më kërkesën e datës 27.02.2025, duke udhëzuar së për qasje për punëtore në burime njerëzore ka vetëm udhëheqësi i juaj i drejtpërdrejtë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është i përlllogaritja pushimit vjetor për periudhën sa ka qenë në fuqi Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, duke shtuar tutje se keq llogaritja është bërë nga vitit 2024 dhe kjo ka ndikuar negativisht në të drejtat e saj. Kërkon që ankesa të aprovohet dhe të mos i mohohet e drejta në llogaritjen e ditëve të pushimit vjetor.

Duke ju referuar pretendimit ankimor së llogaritja e përvojës së punës të bëhet për kohën sa ka qenë në fuqi Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit fillimisht thekson faktin e pakontestueshme së Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka qenë në fuqi nga data 11.07.2010 deri me 08.07.2020, ndërsa nga data 09.07.2020 ka qenë i aplikueshëm Ligji 06/L-113 për Zyrtarët Publikë, i cili ka përcaktuar rregullim tjetër ligjor lidhur më kohëzgjatjen e pushimit vjetor të zyrtareve publik. Rrjedhimisht sipas nenit 39 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, përcaktohej se: *“1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në pushim vjetor dhe në pushim për festa zyrtare në përputhje me kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi. 2. Gjatë çdo viti kalendarik, nëpunësi civil ka të drejtë në pushim vjetor me pagesë me kohëzgjatje minimale prej tetëmbëdhjetë (18) ditë pune, në shkallën prej një ditë e gjysmë (1.5) për çdo muaj kalendarik të punësimit. 3. Kohëzgjatja e pushimit vjetor*

do të përcaktohet në bazë të përvojës së punës dhe me këtë rast çdo dy (2) vjet përvojë pune e rrisin pushimin vjetor për një (1) ditë pune...” Ndërsa Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik më nenin 18 paragrafi 4, ka përcaktuar: **4. Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës.** E në ndërlidhje më këtë të fundit, Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, me nenin 32 përcakton se: **1.I punësuari gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar. 2. Zgjatja e pushimit vjetor përcaktohet varësisht nga stazhi i punës, ku për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës, shtohet një ditë pune.**

Andaj, bazuar në kuadrin ligjor si më sipërdhe dukë qenë se nga analizimi i provave të çështjes rrjedhë se ankuesja marrëdhënien e punës në pozitën e shërbyesit civil e ka themeluar më datë 26.08.2019, pra në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe meqenëse ankuesja deri në emërimin e saj në pozitën Zyrtar për Shëndetësi, nuk ka dëshmuar së e njëjta ka të themeluar ndonjë marrëdhënie pune sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, atëherë, e njëjta për periudhën nga 26.08.2019 deri me 08.07.2020 (si datë ku nuk ka qenë më i aplikueshëm Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil) ka pasur vetëm 11 muaj përvojë punw sipas kwtij ligji, atëherë, ankuesja nuk ka mundur dhe nuk mund të përfitoj nga e drejta në pushim vjetor sipas përvojës së punës në shërbim civil siç përcaktohej më nenin 39 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës, kështu që, pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk gjëne mbështetje ligjore.

Rrjedhimisht, bazuar në konstatimin si më sipër, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin përcaktues së kohëzgjatja e pushimit vjetor për ankuesen sipas përvojës sw punës llogaritet vetëm sipas nenit 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ndërlidhur më nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku parashihet se: **“1. Orari i punës dhe pushimet e zyrtares/it publik rregullohen në përputhje me legjislacionin përkatës për punë”.** Kështu që, mbi bazën e këtyre rrethanave ligjore, dhe marrë për bazë përvojën e punës të njohur më Vendimin Nr.24/2025, të datës 30.01.2025, sipas të cilit akt ankueses i janë njohur 21 vite e tre muaj përvojë punë, fakt ky që nuk është kontestuar nga ankuesja, atëherë, Kolegji vlerëson së pushimi prej 24 ditëve (20 ditë pushim vjetor, dhe 4 ditë pushim sipas përvojës së punës) është i drejtë.

Përmbledhura si më lartë, e duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVES
Lënda me numër A.nr.477/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses Fatlinda Hoxha;*
- *Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*